



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 236 .prot

Koplik më: 22.01 /2024

V E N D I M

Nr 5 , Date 18 / 01 / 2023

PËR
PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË
SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË
BASHKISË MALESI E MADHE

Keshilli Bashkiak Malesi e Madhe në mbledhjen e dates 18.01.2024, Bazuar në urdherin nr.183 date 12.12.2023 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira sipas kërkesave ,si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Per Vetgqeverisjen Vendore” neni 54 pika e/1 neni 64 germa c, ligjin nr.57/2020 “ Per Pyjet ”, si dhe VKM nr.888 date 27.12.2022 “Per rastet e dhenies në perdorim dhe për ndryshimin e kategorise së perdorimit, procedurat dhe dokumentacioni perkates për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakesimin në volum nga fondi pyjor kombetar apo zgjerimin e tyre”, Udhezimi e Ministrit Te Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Per rregullat ,procedurat e kerkimit ,te shqyrtimit e te miratimit te kërkesave për dhenien në perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik”, Udhezimi e Ministrit Te Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Per rregullat ,procedurat e kerkimit ,te shqyrtimit e te miratimit te kërkesave për dhenien në perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik”. VKM nr. 599 dt.29.07.2022 të Keshillit të Ministrave “Per percaktimin e tarifave për dhenien për shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar,per veprimtari ekonomike , si dhe per prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, date 08.06.2016 , të Keshillit të Ministrave , “Per transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave te inventarit , dhe aktualisht në administrim te Ministrise së Mjedisit e te ish Komunave /Bashkive “, të ndryshuar.

V E N D O S I :

1. Rinovimin e kontrates nr. 6418 prot. date 08.10.2018 mes Shoqesise MATEO & CO dhe Bashkise Malesi e Madhe “për dhenien në perdorim të fondit pyjor/kulosor publik, me siperfaqe prej 0.2469 ha në nëngastrat 14b;62;70b;72a, ekonomia Pyjore “Lugina e CEMIT si dhe siperfaqen prej 0.1398 ha te hequr nga fondi pyjor duke ndryshuar kategorine e perdorimit të territorit ,funksionin ,formen e qeverimit dhe treguesit kryesore te grumbujve në ngastren nr.62,72a në ekonomine pyjore Lugina e Cemit”.
2. Siperfaqja prej 0.2469 të jepet në perdorim (qira) për nje afat 10 vjecar si dhe gjatesite lineare në km sipas perdorimit/pronesise), nëngastrat 14b, 62, 70b, 72a, ekonomia pyjore “Lugina e Cemit” si dhe hapje kanali dhe shtrim tubacioni me gjatesi 2.212 km .
3. Viera totale e dhenies me qira eshte 257 667.5(dyqind e pesedhjete e shtate mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate presje pese) leke/vit.
4. Viera e investimeve qe do te kryhen (pyllezime, zevendesime, permiresime, etj.) si dhe vlere e bimesise pyjore, flores, faunes për siperfaqen qe do te zevendesoje siperfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor për 0,1398 ha eshte 164 055 (njeqind e gjashtedhejte e kater mije e e pesedhjete e pese) leke.
5. Viera e bimesise pyjore flores dhe faunes, kullotjes si dhe investimet qe do kryhen eshte 10 880 (dhjete mije e teteeqind e tetedhjete) leke.
6. Lidhjen e kontrates me te drejte rinovimi në perfundim te afatit 10-vjecar, nëse asnjera nga palet nuk kerkon në mënyrë te arsyetuar zgjidhjen e saj.
7. Per zbatim te ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise Malesi e Madhe si dhe Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit të Aseteve.

Bashkangjitur, raporti mbi studimin tekniko ekonomik te hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit 139/2015, “Per veteqeverisjen vendore”

KRYETAR

Mir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmuaj

Miratuar me 18.01.2024

Vota Pro 25

Vota Kunder 4

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 18.01.2024





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETVE
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 3413.prot

Koplik më: 25 / 12 /2023

PROJEKT -VENDIM

Nr _____, Date _____ / _____ / 2023

**PËR
PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË
SIPËREAQVE NË PRONËSI PUBLIKE TË
BASHKISË MALESI E MADHE**

Bazuar ne urdherin nr.183 date 12.12.2023 te Kryetarit te Bashkise per vleresimin tekniko-ekonomik te siperfaqes pyjore per dhenie te fondit pyjor me qira sipas kerkesave ,si dhe ne mbeshtetje te Ligjit nr. 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” neni 54 pika e/l nenit 64 germa c, ligjin nr.57/2020 “ Per Pyjet ”, si dhe VKM nr.888 date 27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorie se perdorimit, procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet c siperfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apo zgjerimin e tyre”, Udhezimi e Ministrit Te Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Per rregullat ,procedural e kerkimit ,te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kulllosor publik”. VKM nr. 599 dt.29.07.2022 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e tarifave per dhenien per shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar,për veprimtari ekonomike , si dhe per prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” si dhe bazuar ne VKM. Nr.433, date 08.06.2016 , te Keshillit te Ministrave , “Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave te inventarit , dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish Komunave /Bashkive , te ndryshuar.

VENDOSI:

Qe ti propozojë Keshillit të Bashkise Malesi Madhe që të miratojë :

- I- Rinovimin e kontrates nr. 6418 prot. date 08.10.2018 mes Shoqesise MATEO & CO dhe Bashkise Malesi e Madhe “për dhenien në perdorim te fondit pyjor/kulosor publik, me siperfaqe prej 0.2469 ha në nengastrat 14b;62;70b;72a, ekonomia Pyjore “Lugina e CEMIT si dhe Siperfaqen prej 0.1398 ha te hequr nga fondi pyjor duke ndryshuar kategorinë e perdorimit te territorit ,funksionin ,formen e qeverimit dhe treguesit kryesore te grumbujve në ngastren nr.62,72a në ekonomine pyjore Lugina e Cemit”.
- II- Siperfaqja prej 0.2469 të jepet në perdorim (qira) për një afat 10 vjecar si dhe gjatesite lineare në km sipas perdorimit/pronesise), nengastrat 14b, 62, 70b, 72a, ekonomia pyjore “Lugina e Cemit” si dhe hapje kanali dhe shtrim tubacioni me gjatësi 2.212 km .
- III- Viera totale e dhenies me qira është 257 667.5(dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje pese) lek/vit.
- IV- Viera e investimeve qe do te kryhen (pyllezime, zevendesime, permiresime, etj.) si dhe vlера e bimesise pyjore, flores, faunes për siperfaqen qe do te zevendesojë siperfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor për 0,1398 ha është 164 055 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e pese) leke.
- V- Viera e bimesise pyjore flores dhe faunes, kullotjes si dhe investimet qe do kryhen është 10 880 (dijete mijë e tetëqind e tetëdhjetë) leke.
- VI- Lidhjen e kontrates me te drejte rinovimi në perfundim të afatit 10-vjecar, nëse asnjëra nga palet nuk kërkon në mënyrë të arsyetuar zgjidhjen e saj.
- VII- Per zbatim te ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise Malesi e Madhe si dhe Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit te Aseteve.

Bashkangjitur, raporti mbi studimin tekniko ekonomik te hartuar nga Drejtoria e Administrimit te Pyjeve.

Faleminderit për mirekuptimin

Punoi: E. Smakaj(Specialist Jurisft
Miratoi: E. Adenijaj (Drejtor)
Nr i kopjeve: 2(dy)
Nr i fleteve: 2(dy)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALESI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. **Δi**/Prot.
h

Koplik ,mg **2V**/2 /2023

Relacion

PËR

**PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË
SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË
BASHKISË MALESI E MADHE**

Kryetari i Bashkise Malesi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen
vendore”, nenit 64 germa c , nenit 54 germa e/1 propozon:

Te nderuar keshilltai e

Bazuar në kërkesen e shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k me shkresen nr.extra Prot, date
12.12.2023 ku ka kërkuar rinovimin e kontrates së qirase pgr pgrdorim tg sipërfaqes pyjore per
ndertim HEC-i “Murasi”. Kjo kontratg ka qeng e e lidhur pgr njg afat 5 vjecar.

Mg lejoni tu paraqes relacionin pgr raportin mbi studimin teknik pgr miratimin e rinovimit tg
kontratave sg qirasg per ndertim HEC-i “Murasi” tg shoqerisg “MATEO & CO” sh.p.k . tg
sipërfaqeve pyjore ng ekonoming pyjore /kullosore “Lugina e Cemit”, ng ngastrat/ngngastra
ngngastrat 14b, 62, 70b, 72a, ng Njesia Administrative Kelmend,pgr dhgnien ng pgrdorim nga
fondi pyjor i sipgrfaqes totale,0.2469 ha pgr njg afat 10 (dhjete) vjegar.

*Sipërfaqja prej 0.1398 ha eshte hequr nga fondi pyjor sipas urdherit te ministrit te mjedisit
Nr.116 date 14.04.2017 duke ndiyshuar kategorine e perdorimit te territorit funksionin ,/onnen
e qeverimit dhe treguesit ktyesore te grumbujve në ngastren nr.62,72a në ekonomine pyjore
Lugina e Cemit*

Tarifat e dhgnies ng pgrdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen VKM nr.888 date
27.12.2022 “Pgr rastet e dhgnies ng pgrdorim dhe pgr ndryshimin e kategorisg sg pgrdorimit,
procedurat dhe dokumentacioni pgrkatgs pgr ndryshimet e sipgrfaqeve dhe pakgsimin ng volum
nga fondi pyjor kombgtar apo zgjerimin e tyre,Udhgzimin e Ministrisg sg Mjedisit nr.1.datg
09.06.2016 p”Pgr rregullat, procedurat e kgrkimit, tg shqyrtimit e tg miratimit tg kgrkesave pgr
dhgnie ng pgrdorim tg fondit pyjor dhe kullosor publik”.

Vlera totale e dhenies me qira ne vit eshte
257667.5(dyqindepesedhjeteeshtatemi eegjashteqindesgjashtedhjeteeshtatepikepese)
leke.

Vlera e perdorimit per linjat gjatesore ne km perdorimin per kanalet, tubacionet, linjat e tensionit
te larte, ne rastet e HEC-eve, ph'te 246787.5 leke.

Vleren e bimesise pyjore, flores, faunes dhe kullotjes ne shumen prej 10880 leke

Vleren e investimeve qe do te kryhen (pyllezime, zevendesime, permiresime, etj.) per siperfaqen
qe do te zevendesojte siperfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor per 0,1398 Ha = 1 64055
leke, shume e cila do te paguhet vetem vitin e pare te lidhjes se kontrates.

Tarifat e dhenies ne perdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen VKM nr.559 date
29.07.2022


Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko ekonomik.

Ju faleininderit per bashkcpimimin tuaj.

KRYETAR

TONIN MARINAJ

Punoi: E. Smakaj(Specialist Jurist/
Miratoi:E. Ademaj (Drejtore)
Nr i kopjeve: 2(dy)
Nr i fleteve: 2(dy)



Nr. 44 * Prot.

Koplik , më J 15 / CC / 2018

KONTRATË QIRAJE

PËR

DHENIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PUBLIK


Ne zbatim të Ligjit Nr. 9385 date 04/05/2005 “Per Pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar , të Ligjit Nr. 9693. date 19/03/2007 “Per fondin Kullor” të ndryshuar, të Vendimit Nr. 1064 date 22.12.2010. të Udhëzimit Nr.01 date 09.09.2016 “Per rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”. Urdhërit 116 date 14.04.2017 “te Ministrise se Mjedisit, si dhe në mbështetje të “ Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, lidhet kjo kontratë qiraje midis:

Bashkise Malesi e Madhe me NIPT K48420701I, e përfaqësuar nga z.Tonin Marinaj/Kryetar, përfaqësues i vetëm që më poshtë do të quhet “Qiradhenes”, dhe

MATEO & CO shpk me NIPT L 61720018 E, e përfaqësuar nga znj.Elona Nikollaj/ Administratore. me adresë Tiranë Njesia Bashkiake Nr. 1 Rr. Ali Demi, pallati 269 shk.1 ap. 1. Kati 1, që më poshtë do të quhet “ Qiramarres ”.

Neni i Përkufizimit

- Sipërfaqe përdorimi: Vendi në të cilin do të ushtrohet veprimtaria për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj të miratuar.
- Qiradhenes Autoriteti i bashkisë që zotëron të drejtën e përdorimit dhe përgjigjet për menaxhimin e administrimin e fondit pyjor/kullor.
- Qiramarresi Subjekte fizike ose juridike.



Neni 2: Objekti i kontrates

DTienia në perdorim të sipërfaqes pyjore/kullosore në pronesi të Bashkise Malesi e Madhe për shtrim linje TL me gjatesi 2.152 km. hapje kanali dhe shtrim tubacioni me gjatesi 2.212 km për ndertimin dhe funksionin e HEC "MURASI ", konkretisht:

Ngastral: 14 b,62. 70 b,72a,

Sipërfaqja që jepet në perdorim: 0,2469 ha

Ekonomia pyjore: Lujina e Cemit

Kufizimet:

Veri:-----

Jug:-----

Lindje:-----

Pergndim:-----



Neni 3:Qellimi


Kontrata për dhienien në perdorim të sipërfaqes së përcaktuar, për ushtrimin e veprimtarisë hapje kanali dhe shtrim tubacioni në funksion të hidrocentralit, është e vlefshme vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga Ministria e Mjedisit për Ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë si dhe në Lejen e Mjedisit.

Neni 4:Afati i Kontrates

- 4.1 Kontrata e Qirase lidhet për një afat 5 vjeçar duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
- 4.2 Palet duhet të njoftojnë njëra-tjetër 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të mesipem, për të negociuar kushtet e kontratës.
- 4.3 Në mungesë të këtij njoftimi ose të ndonjë komunikimi midis palëve, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 5:Vlera e qirase

- 5.1 Vlera e Qirase vjetore për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor të dhene me qira është 374 540 (treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dyzet) lek.
- 5.2 Vlera totale e kontratës është e llogaritur sipas raportit teknik.



Neni 6:Pagesa dlle regjimi i saj

6.1 Pagesa do të behet brenda (10) diteve nga nenshkrimi i kontrates nga palet.

6.2 Qiraja do të paguhet në Bankat e Nivelit të dytë.

6.3 Në rast se Qiramarresi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të kontrates të vendosura më sipër "Qiradhenesi" përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës së pagesës perkatese. Për efekt të llogaritjes së kamatës vonesave do të konsiderohet data e percaktuar në pikën 6.1 të kësaj kontrate.

Neni 7: Te drejtat dhe detyrimet e Qiradhenesit

7.1 Qiradhenesi merr persiper dhe garanton "Qiramarresin" që të kryejë sipërfaqen e percaktuar në kontratë, i krijon Qiramarresit mundësinë që të gëzojë dhe përdorë objektin që është ndaj pretendimeve pronësore të ngritura nga të tretet.

7.2 Qiradhenesi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontrates.

7.3 Qiradhenesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontrates kur Qiramarresi nuk ka shpërblen e qirës sipas percaktimeve të nenëve 5 dhe 6 të kësaj kontrate, demton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të percaktuara në kushtet e Lejes Mjedisore si dhe aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

Neni 8: Te drejtat dhe detyrimet e Qiramarresit


8.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Qiramarresi ka të drejtë që për të punësuarit e tij, agjentët, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që "Qiramarresi" konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtë të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; në zbatim të kushteve dhe qëllimeve të percaktuara në nenët 1, 2 dhe 6 të kësaj kontrate; të transportojë persona, mallra, pajisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes së marrë me qira, të bëjë punime të përkohshme si dhe punime të tjera të çdo natyre në përputhje me kërkesat e Lejes Mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të saj.

8.2 Qiramarresi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tregtojë pa marrë më parë miratimin nga Qiradhenesi për ushtrimin e veprimtarisë.

8.3 Qiramarresi nuk ka të drejtë të japë me nënqira dhe të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjerë apo të kalojë kontratën e lidhur me subjektin tjetër.

8.4 Qiramarresi do të kryejë me shpenzimet e veta çdo punim mirëmbajtjeje që do të konsiderojë të nevojshëm në sipërfaqen e marrë në përdorim.

8.5 Qiramarresi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim me qëllim për të ushtruar aktivitetin që percaktohet në kontratë.



8.6 Qiramarresi ka për detyrim, të mbroje dhe të administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9385 . date 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9693, date 19.03.2007 për fondin kullosor ,të ndryshuar.

8.7 Qiramarresi ka për detyrim, të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve prandaj bashkë të ushtrorin kontrollin për zbatueshmërinë e kërkesave të percaktuar në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor të dhënë në përdorim.

8.8 Qiramarresi detyrohet të zbatojë gdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet dhe kullotat dhe gjuetinë.

8.9 Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të meslqgrme të kontratës zbatohen kërkesave të ligjit Nr. 9385 date 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor të ndryshuar.

Neni 9: Detyrime të përbashkëta të paleve

Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj, Qiramarresi do të rehabilitojë sipërfaqen për gdo dëmtim që mund të jetë shkaktuar gjatë veprimtarisë ,dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marrë siç ishte në gjendjen fillestare ,përveç konsumit fizik normal.

Neni 10: Forca mëdhe

Në rast se ndonjë nga palët e kësaj kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë, si pasojë e Forcës Mëdhe. kjo palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Mëdhe. Përzullimi i ekzekutimit të kësaj kontrate si pasojë e Forcës Mëdhe do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Mëdhe.

Neni 11: Zgjidhja e kontratës

11.1 Kontrata zgjidhet me marrëveshje midis paleve si dhe me mbarimin e afatit të zgjatjes së kontratës.

11.2 Kontrata bëhet menjëherë e pavlefshme ,nëse nuk është nënshkruar pasi të jetë marrë miratimi nga institucioni, sipas kërkesave të nenit 17 të Ligjit Nr. 9385, date 04.05.2005 “Për pyjet dhe sherbimin pyjor”, të ndryshuar me nenin 17 të Ligjit Nr.9693. date 19.03.2007 “Për fondin kullosor” të ndryshuar si dhe kontrata është e pashoqeruar me hartën përkatëse të gjeoreferuar në koordinata përkatëse.

11.3 Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj në mënyrë të menjëhershme, vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve të lejes mjedisore, për sipërfaqen e dhënë në përdorim nga Qiradhenesi.

11.4 Kontrata zgjidhet menjëherë kur sipërfaqja e dhënë në përdorim kërket për interes publik të miratuar nga K.RR.T apo KRRTRSH.

11.5 Kontrata zgjidhet menjëherë kur sipërfaqja e dhënë në përdorim përshkohet nga zjarri.

rv
& ¥
W

11.6 Kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme kur Qiramarresi, për sipërfaqen që kryen veprimtari e nuk e kanë rehabilituar në përputhje me planin e rehabilitimit të miratuar nga organet të ngarkuara me ligj.

11.7 Njoftim për zgjidhjen e njëanshme të kontratës behet me shkriin i dite për para zgjidhjes së saj.



Neni 2: Dispozitat e fundit

Për gëshjtet që nuk trajtohen në kontratën e mesipërme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë Kontratën e Qirase.

Mosmarrveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate zgjidhen me mirekuptimin e paleve, në të kundërt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkoder.

Çdo korrigjim i kontratës pas nensbkrimit të saj e bën të pavlefshëm.

Kjo kontratë Qiraje u formulua në 4 kopje, nga të cilat një e merr "Qiramarresi" dhe të Bashkia Malesi e Madhe.

PALET

Qiradhenesi

Qiramarresi

BASHKIA MALESËS E MADHË

"MATEO & CO" shpk

KRXETAR

IONIN MARINAJ

ADMINISTRATOR

**ELC rtfi MIKOLAJ
ELONA NIKQJ/CAJ**

Lt¹ JSSSL

Konceptoi: R. Rrjolli (Specialiste juriste)

Miratoi: E. Adeinaj (Përgjegjës sektori)

Nr i kopjeve : Pesë (5)

Nr i fletëve: 5 (peshë)

M3?

Mr*

REPUBLIKA E SHQUIPERISE
ENTI RREGULLATOK I ENERCJISE

LICENCE
PER
VEPRIMTARINE E PRODHIMIT TE ENERGISE ELEKTRIKE



ScrU: P2Q

Numrl i Licences: 471

Data e Hyrjes nC Fuql: Vcndiml i Bordlttg ERE-s Nr. 155. date 07.10.2020

Licenca i jepet : MMATEO & CO" ih.p.L

NUIS: L61720018E

Bazuar nfi autoritetin qe i eshte dhene n6 PjesCn e Peste te Ligjit Nr. 43/2015 "Per SektorIn e Energjise Elektrike", Enti Rregullator i Energjise ("ERE") i jep kete Licence Prodhimi ("Licenca"), per te layer aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike (PEE) ose/dhe pgr te permbushur detyrimin e sherbimit publik/universal, Personit te lartpemiundur, i quajtur "I Licencuari", subjekt i Kushteve te kesaj Licence si dhe kushteve te percaktuara ne Veodimin e Bordit te ERE-s nr. 155, date 07.10.2020. Kjo Licence hyn ne fuqi ne daten e shkruar me lart dhe do te vazhdoje te jete ne fuql deri ne daten 07.10.2050, ne rast se nuk hiqet nga ERE n6 peiputhje me Kushtet e Licences te perfshira ketu.

KRYETARI
Petrit AHMETI



REPUBLICA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRI

Jid 3189

URDHËR

Nr. JUj, Date 27.01.2011



„ PËR

VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJE NGA FONDI PYJOR DUE KULLOSOR PUBLIK TË NJË SIPËRFAQE PREJ 0.1398 HA NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË HEC “MURASI 1 dhe 2”, NË KASKADËN E LUMIT “CEMI I SELCËS”, NGA SHOQËRIA “MATEO&CO” SH.P.K., NË BASHKINË MALËSI E MADHE.

Ne mbështetje të pikes 4 të nenit 102 të Kushtetutes, të shkronjes “d” të nenit 28 të ligjit nr. 9000, date 30.01.2003 “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Ministrave, , në nenin 17, të ligjit nr. 9385, date 04.05.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor”, të ndryshuar, në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 1353, date 10.10.2008 “Per rregullat dhe paraqitjen e kerkeses, mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik, kiiteret dhe procedurat e zvogelimit të siperfaqes dhe të vellimit të fondit pyjor”, të ndryshuar, në kerkesen e Ministrise së Energjise dhe Industrise nr.1806/1 prot., date 06.04.2017, të aktit të miratimit paraipak nr.3714/4, date 36.10.2016, në vnm paraprake me nr. identifikimi 712, datë 02.12.2016 dhe në dakortesine e kiyetarit të baslikise Malesi e Madhe nr.1190, date 07.04.2017,

URDHËROJ:

1. Vijimin e procedurave që duhet të ndjeko struktura pergjegjese për pyjet në bashkine Malesi e Madhe për heqjen nga fondi pyjor dhe kulllosor publik të nje siperfaqe prej 0.1398 ha në ngastrat 62 dhe 72 a të ekonomise pyjore “Lugina e Cemit”, që do të perdoret si shesh ndertimi të godinave të Hec-ve “Murasi 1 dhe 2”.
2. Struktura pergjegjese për pyjet në bashkine Malesi e Madhe, në prani të perfaqesuesve të shoqerise “Mateo&Co”sh.p.k., të :
 - a. shenoje në terren poligonin me siperfaqen pyjore objekt i ndertimit të godinave të Hec-it që hiqet nga fondi pyjor dhe të siperfaqes perkatese, objekt i kontrates së perdorimit me baslikine.

- vf
- b. beje vleresimet në volum e vlere për lenden drusore dhe pasurite e tjera pyjore që hiqen gjate kryerjes së punimeve dhe të mbaje aktet perkatese,
 - c. monitoroje rehabilitimin dhe pyllëzimin e sipërfaqes sipas marreveshjes ndërmjet bashkise dhe shoqërisë ndërtuese.

3. Shoqëria "Mateo&Co" sh.p.k, të:

- a. rehabilitojë sipërfaqet pyjore objekt ndërtimi sipas planit të punës dhe lejes mjedisore, të përcaktuara në marrëveshjen me bashkinë e Madhe.
 - b. të kthejë pagesat në llogarinë rrjedhëse të bashkisë Malesi e Madhe sipas përcaktimeve në raportin tekniko-ekonomik, bazuar në tarifat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar, dhe realizon detyrimet sipas përcaktimeve në marrëveshjen me bashkinë.
4. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ben regjistrimin e sipërfaqes pyjore/kullosore publike të identifikuar sipas lidhjes 1 (nje) te këtij vendimi, nga kategoria "Toke pyjore/kullosore" dhe e regjistron në kategorinë "Toke e zënë, objekt i ndërtimit të godinës së Hec-ve "Murasi 1 dhe 2", në pronësi publike të bashkisë Malesi e Madhe.
5. Ndryshimet në regjistrin kadastral për sipërfaqet objekt i ndërtimit të godinave të Hec-it, behen në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit nr.1, datë 26.01.2017 "Për mbajtjen e kështre të fondit pyjor dhe kullosor".
6. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Struktura Përgjegjëse për Pyjet në bashkinë Malesi e Madhe dhe shoqëria "Mateo&Co" sh.p.k/

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

Letter KOKA
W. MINISTER

Bashkia MALËSI e MADHE



LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DIJE KULLOSOR PUBLIK

OË mOEN PËR NDËRTIMIN E HEC " Murasi 1&2" nga shoqeria "Mateo&Co" shpk

Nr.	ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/ 11/ngast.	Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor ha
1	2	3	4	J
1	MA06 00 062	Lugina e Cemit	62	0.1078
2	MA06 00 072 a	Lugina e Cemit	72 a	0.032
GJITHSEJ				0.1398

